



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 4 regjistër (JR)
Datë 21.01.2021

Nr. 33 i vendimit
Datë 24.07.2023

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 24.07.2023, ditën e hënë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Gerrit Sprenger, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Alket Mersini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 296, datë 16.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Alket Mersini.

BAZA LIGJORE: Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 61, 63 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenet 46, 47, 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet me shkrim, i cili përfundimisht kërkoi konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Alket Mersini (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në kuadër të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {***} prot., datë 17.04.2018, duke konstatuar se:
 1. deklarami nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
 2. ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;
 3. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 4. nuk ka kryer deklaram të rremë;
 5. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
4. DSIK-ja, në funksion të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, ka hartuar raportin nr. {***} prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të

ligjit nr. 84/2016, tek i cili ka konkluduar mbi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Alket Mersini.

5. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raportin e arsyetuar me nr. {***}, datë 15.05.2020, për subjektin e rivlerësimit.
6. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të sipërcituara për subjektin e rivlerësimit, zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar në tri kriteret e vlerësimit, atë të pasurisë, të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka arritur në përfundimin që subjektit të rivlerësimit Alket Mersini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 296, datë 16.09.2020, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra, është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për secilin prej kriterëve të vlerësuar.

7.1. Për vlerësimin e kriterit të pasurisë: *Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e mbledhur nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror, konstaton se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive apo kryerjen e shpenzimeve ndër vite; (ii) ngrihen dyshime të arsyeshme se pasuria e llojit automjet, megjithëse ka kaluar në pronësi të subjektit formalisht në vitin 2015, që në prill të vitit 2008 është porositur dhe blerë nga subjekti i rivlerësimit dhe se, me veprimet dhe mosveprimet e tij, është munduar të fshehtë këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj; (iii) ngrihen dyshime të arsyeshme për qëllimin e kryerjes së transfertës në favor të bashkëshortes së subjektit nga shoqëria “{***}” ShPK, në tetor të vitit 2011, në vlerën prej 40.774 eurosh, të lidhura me trajtim të mundshëm preferencial nga shoqëria për çmimin e blerjes së apartamentit të “{***}”. Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (1) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara; dhe (2) ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.*

7.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Alket Mersini, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

7.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësisë profesionale: [...] *Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, të miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilat është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.*

III. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

8. Më datë 11.12.2020, është depozituar nga subjekti i rivlerësimit, ankimi i protokolluar në Komision me nr. {***} prot., kundër vendimit nr. 296, datë 16.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63¹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në konkluzion të ankimit të tij, subjekti i rivlerësimit kërkoi sa në vijim:
- (i) Prishjen e vendimit nr. 296, datë 16.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
 - (ii) Konstatimin e pavlefshmërisë së procedurës së hetimit administrativ, seancës dëgjimore dhe përfundimtare të trupit gjykues.
 - (iii) Marrjen e provave të kërkuara bashkëlidhur ankimit.
 - (iv) Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.
 - (v) Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Alket Mersini me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8.1. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

8.1.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka detyrimin ligjor t'i kalojë barrën e provës subjektit të rivlerësimit, për çdo gjetje që përbën mospërmbushje detyrimi ligjor nga ana e subjektit dhe ka si sanksion marrjen e një mase disiplinore, pra një dënimi administrativ. Ky moment procedural duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërdrejt subjektit të rivlerësimit, pikërisht në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente, për t'u dëgjuar e mbrojtur në kuadër të një procesi të rregullt ligjor sipas nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim "KEDNJ").

8.1.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se procesi i rivlerësimit është një proces disiplinor dhe në nenin "Ç" të Aneksit të Kushtetutës parashikohet shprehimisht se në këtë proces zbatohen parimet e procesit të rregullt ligjor. Subjekti pretendon se në procesin disiplinor zbatohen parimet, si: e drejta për një proces të rregullt, ligjshmëria, mosdënimi pa ligj, barazia para ligjit, prezumimi i pafajësisë, dyshimi në favor të magjistratit, proporcionaliteti, pavarësia dhe paanësia e institucioneve disiplinore. Subjekti pretendon se Komisioni e ka mbështetur vendimmarrjen në dyshime dhe jo në fakte të vërtetuara, duke cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor.

¹ "Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit".

8.1.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm, duke argumentuar se Komisioni përbëhet nga 12 anëtarë të zgjedhur nga një komitet *ad hoc* i Kuvendit të Shqipërisë dhe asnjë anëtar nuk ka ardhur nga sistemi gjyqësor në momentin e emërimit. Mandati i shkurtër i Komisionit e bën atë një organ të ndikueshëm dhe jo të pavarur.

8.1.4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë procesit të hetimit administrativ dhe seancës dëgjimore në Komision, nuk është respektuar parimi i sigurisë juridike, i cili përfshin qartësinë, kuptueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit normativ, si dhe besimin te sistemi juridik. Subjekti pretendon se shkaku kryesor i vendosur në themel të vendimmarrjes është konstatimi si e ardhur e paligjshme e shumës së përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan në vitin 2011, për shkak se sipas Komisionit, për këtë shumë nuk janë paguar detyrimet tatimore. Ky konstatim nuk është në përputhje me legjislacionin tatimor të kohës dhe asnjë organ ligjzbatues nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë shumë. Si rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për marrjen e masës disiplinore është në shkelje të parimit të sigurisë juridike.

Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë

8.1.5. Lidhur me ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 120 m², të ndodhur në Elbasan, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të shumave të marra/dhuruara nga vëllai dhe familja e bashkëshortes. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasqyrimi i gabuar i vitit të dhënies së këtyre shumave në deklaratat e personave të tjerë të lidhur, është gabim material. Subjekti i rivlerësimit argumenton se nga analiza e Komisionit, ka rezultuar se personi tjetër i lidhur ka pasur mundësi financiare për të dhënë shumën 10.000 USD dhe ky konkluzion duhet të ishte analizuar nga Komisioni për të mos i dhënë rëndësi gabimit material të shënimit të vitit 2004 në vend të vitit 2003 në deklaratat e personave të tjerë të lidhur, të administruara gjatë hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij në agjencinë “{***}” ShPK, në vlerën 537.500 lekë, në periudhën 1997-1999, duhen të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, pasi detyrimin për kryerjen e pagesave tatimore nuk e ka subjekti dhe as bashkëshortja e tij. Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur mundësi me burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për prenotimin.

8.1.6. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 120 m², ndodhur në Elbasan, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se për të ardhurat e krijuara nga shitja e të drejtave reale mbi këtë pasuri në vitin 2011, subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin dhe pagimin e detyrimeve tatimore. Subjekti pretendon se Komisioni ka anashkaluar përgjigjen që i ka dhënë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në të cilën nuk konstatohej se për këtë të ardhur të krijuar duhet të paguhen detyrime tatimore. Subjekti pretendon se Komisioni në mënyrë të qëllimshme, për të rënduar pozitën e subjektit, i referohet legjislacionit tatimor, njëlloj sikur pasuria e subjektit të ishte e regjistruar në regjistrat publikë, edhe pse kjo e fundit nuk ishte e regjistruar në momentin e shitjes. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, e ardhura e

përfitur nga shitja e apartamentit në vitin 2011, duhet të konsiderohet si e ligjshme dhe të përfshihet në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

8.1.7. Lidhur me pasurinë e luajtshme automjet, tip “Mercedes Benz”, me targë {*}, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk i ka kaluar barrën e provës, pasi nuk ka kërkuar asnjë shpjegim, si dhe nuk i ka njoftuar asnjë gjetje, e cila mund të çonte në marrjen e masës disiplinore. Subjekti i rivlerësimit argumenton se rregullat për kalimin e barrës së provës, duhet të zbatohen me ekzaktësi dhe korrektësi nga institucionet e rivlerësimit për shkak se mosrespektimi i tyre cenon drejtpërdrejt procesin e rregullt ligjor. Në përfundim të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet në vendim për automjetin, janë në kundërshtim me të dhënat e administruara, por edhe me parimet e procesit të rregullt ligjor.**

8.1.8. Lidhur me depozitën në bono thesari, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit, se kjo depozitë e hapur në vitin 2011, e cila ka për burim të ardhurat nga shitja e të drejtave reale të apartamentit në Elbasan, nuk është krijuar me burime të ligjshme. Subjekti pretendon se këto të ardhura janë plotësisht të ligjshme, si rrjedhojë edhe burimi që ka shërbyer për krijimin e depozitës në bono thesari, është tërësisht i ligjshëm.

8.1.9. Lidhur me transfertën e kryer nga shoqëria “{*}” ShPK në llogarinë e bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se llogaria e hapur në Union Bank nga bashkëshortja e tij, në ditën e kryerjes së transfertës të datës 31.10.2011, nga shoqëria “{***}” ShPK, ngre hije dyshimi se qëllimi i kryerjes së këtij transaksioni lidhet me një trajtim të mundshëm preferencial nga shoqëria lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit. Edhe për këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk i ka kaluar barra e provës nga Komisioni, duke mos i garantuar të drejtën e mbrojtjes, në shkelje të procesit të rregullt ligjor. Subjekti pretendon se nuk ka asnjë provë shkresore ose të dhënë që të provojë se gjatë detyrës të ketë hetuar ndonjë çështje penale që ka të bëjë me shoqërinë “{***}” ShPK. Gjithashtu, pretendoi se çmimi i blerjes së apartamentit nuk ka qenë favorizues, bazuar në çmimin e vendosur në kontratën e shitjes, referencat e publikuara nga Enti Kombëtar i Banesave dhe çmimi në kontrata të tjera të ngjashme.**

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin kalimtar të subjektit Alket Mersini, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim

ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. *Legjitimimi i ankuesit*

10. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 296, datë 16.09.2020, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Alket Mersini, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.

11.1. Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit të paraqitur në ankim, ku kërkoi nga Kolegji që gjykimi i çështjes së tij të zhvillohet në seancë gjyqësore publike, si dhe të administrohen si prova të reja aktet që i ka bashkëngjitur ankimit dhe parashtrimeve të dorëzuara në Kolegj.

11.2. Kolegji vëren se në ankimin e paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, të protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 11.12.2020, janë bashkëngjitur disa akte³ që shoqërojnë ankimin, për të cilat subjekti kërkoi të merren si prova të reja në Kolegj. Më datë 25.11.2022, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj një akt të titulluar “Depozitim provash”, protokolluar në Kolegj me nr. {***}, bashkëlidhur të cilit gjendet kërkesa, datë 23.09.2022, e subjektit të rivlerësimit drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe shkresa kthim përgjigjeje e kësaj të fundit, nr. {***} prot., datë 14.10.2022. Subjekti i rivlerësimit, më datë 18.07.2023, në funksion të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi që do të zhvillohej në Kolegj, më datë

² “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

³ - Udhëzim nr. 3, datë 03.02.2010, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”.

- Kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 18.12.2017.

- Kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.11.2020.

- Kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 20.02.2020.

- Kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 19.06.2019.

- Kontratë për ndërtim apartamenti nr. {***} prot., datë 31.08.2011.

- Shkresë e lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nr. {***} prot., datë 11.12.2020.

24.07.2023, paraqiti kërkesë për kalim në seancë gjyqësore publike, e protokolluar me nr. {***}, së cilës i ka bashkëngjitur edhe disa akte⁴, që kërkoi të merren si prova të reja nga Kolegji.

11.3. Kolegji vëren se bazuar në parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”), i ndryshuar , parashikohet se: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.* Gjithashtu, sipas nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.* Trupi gjykues pasi vlerësoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të lejuar marrjen e akteve si prova të reja, si dhe shqyrtoi kërkesën e tij për gjykimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike, vendosi që këto akte të mos merren në cilësinë e provës, bazuar në nenet 47 dhe 49, paragrafi i dytë i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, si dhe në nenin 49, pika 6, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, duke arsyetuar si vijon.

11.4 Në zbatim të parashikimeve ligjore, lidhur me këtë çështje, Kolegji vlerësoi se për aktet shkresore të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve, nuk provohet se pamundësia e paraqitjes së tyre që në fazën e hetimit administrativ në Komision, nuk ka qenë pa fajin e tij, siç kërkon neni 47 i ligjit nr. 49/2012. Në vlerësim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjitha pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegji, me praninë e subjektit të rivlerësimit për korrigjimin e tyre. Në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në Kolegji, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi. Trupit gjykues të Kolegjit nuk i rezultoi i nevojshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore publike për t’i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për t’u dëgjuar edhe në Kolegji. Kjo edhe për faktin se kërkimi që paraqet subjekti i rivlerësimit, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, nuk rezultoi se bazohet në rastet e parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, Kolegji vlerësoi kryesisht se: (a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; (b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe (c) nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision.

⁴ Shkresë e Komisarariatit të Qarkullimit Rrugor me nr. {***}, datë 08.12.2020, si dhe aktet e paraqitura së bashku me ankimin.

11.5. Kolegji, në konkluzion të arsytimit të mësipërm, vlerësoi si të pabazuar në ligj kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ndaj vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka detyrimin ligjor t'i kalojë barrën e provës për çdo gjetje që, sipas vlerësimit të tij, përbën mospërmbushje detyrimi ligjor nga ana e subjektit dhe ka si sanksion marrjen e një mase disiplinore, pra një dënimi administrativ. Ky moment procedural duhet të jetë i qartë dhe i komunikuar drejtpërdrejt subjektit të rivlerësimit, pikërisht në garantim të së drejtës së tij për të paraqitur prova dhe argumente, për t'u dëgjuar e mbrojtur në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, sipas nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Subjekti i rivlerësimit pretendon se për pasurinë e luajtshme automjet, tip "Mercedes Benz", Komisioni, në rezultatet e hetimit, i ka kërkuar shpjegime të përgjithshme në lidhje me përdorimin e tij, por nuk i ka bërë me dije se kishte arritur në konkluzionin se subjekti është munduar ta fshehtë këtë pasuri. Gjithashtu, subjekti pretendon se lidhur me transfertën e kryer në favor të bashkëshortes nga shoqëria "{***}" ShPK, në datën 31.10.2011, në rezultatet e hetimit Komisioni i ka kërkuar shpjegime të përgjithshme subjektit për kryerjen e transaksionit, por pa përmendur trajtimin e mundshëm preferencial, për të cilin ka arritur në konkluzion për këtë transaksion. Subjekti sa më sipër kërkon: "(i) Kolegji të konkludojë se dy konkluzionet e sipërcituara ku mbështetet marrja e masës disiplinore për ankuesin janë pasqyruar në vendim pa respektuar dispozitat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, neneve 52 e 61 të ligjit 84/2016, si dhe nenit 87 të Kodit të Procedurës Administrative. (ii) Në vendimin përfundimtar që do të merret nga Kolegji, të mos analizohen këto dy shkaqe ankimi, pasi për to subjektit nuk i ka kaluar barra e provës".

12.1 Ky shkak ankimi është trajtuar në vijim në këtë vendim, në shkaqet përkatëse që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, ku subjekti i rivlerësimit ka pasur pretendim për moskalimin e barrës së provës, konkretisht te shkaku i ankimit që i përket pasurisë automjet, tip "Mercedes Benz", si dhe te shkaku i ankimit lidhur me transfertën e kryer në favor të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nga shoqëria ndërtuese "{***}" ShPK. Këto pretendime të subjektit të rivlerësimit do të analizohen më poshtë në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues vlerësoi se subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës nga Komisioni, si rrjedhojë nuk konstatohen shkelje të procesit të rregullt ligjor, duke mos sjellë efekte në drejtim të nevojës për ndryshimin e llojit të gjykimit nga seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve.

13. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se procesi i rivlerësimit është një proces disiplinor dhe në nenin "Ç" të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet shprehimisht se në këtë proces zbatohen parimet e procesit të rregullt ligjor. Subjekti pretendon se në procesin disiplinor zbatohen parimet,

si: e drejta për një proces të rregullt, e ligjshmërisë, mosdënimit pa ligj, barazisë para ligjit, prezumimit të pafajësisë, dyshimit në favor të magjistratit, proporcionalitetit, pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore. Subjekti pretendon se Komisioni e ka mbështetur vendimmarrjen në dyshime dhe jo në fakte të vërtetuara, duke cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Subjekti në këtë ankim ka pretenduar shkeljen e këtyre parimeve në mënyrë të përgjithshme, pa parashtruar rrethana konkrete gjatë procesit të tij të rivlerësimit në Komision, si dhe pa identifikuar shkeljen e kryer nga Komisioni, si dhe pasojën që i ka ardhur prej tyre.

14. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm, duke argumentuar se Komisioni përbëhet nga 12 anëtarë të zgjedhur nga një komitet *ad hoc* i Kuvendit të Shqipërisë dhe asnjë anëtar nuk ka ardhur nga gjyqësori në momentin e emërimit. Mandati i shkurtër i Komisionit e bën atë një organ të ndikueshëm dhe jo të pavarur. Subjekti pretendon se Komisioni ka zbatuar detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, i cili e ka ngarkuar këtë organ me detyrimin për të hetuar dhe njëkohësisht për të gjykuar, parashikime këto, të cilat sjellin si rrjedhojë edhe paragjykimin e çështjes, pasi nga ana tjetër Komisioni nuk i ka vënë në dukje subjektit të rivlerësimit gjetjet të cilat mund ta çojnë atë drejt shkarkimit.

14.1 Lidhur me këtë shkak ankimi, konstatohet se një pretendim i tillë për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar edhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”), e cila në vendimin e saj lidhur me çështjen gjyqësore *Xhoxhaj k. Shqipërisë*, ka arsyetuar: [...] *Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kriterëve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri, është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se anëtarët u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]. GjEDNj-ja në vijim ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar për rrjedhojë shkelje të nenit 6 të KEDNj-së lidhur me sa më sipër.*

14.2 Në vazhdim të analizës së këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mban parasysh se GjEDNj-ja gjithashtu ka vlerësuar se nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të Komisionit për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, nuk mund të konsiderohen se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të subjektit kërkues në seancë publike. Është e rëndësishme që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjitha elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë (*Hauschildt kundër Danimarkës*, 24 maj 1989, paragrafi 50). Si rrjedhojë e sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se fakti që anëtarët e Komisionit nuk kanë ardhur nga sistemi gjyqësor, nuk përbën shkelje të nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në drejtim të parimit të gjykatës së pavarur dhe të paanshme. Gjithashtu detyra e Komisionit për të hetuar dhe njëkohësisht për të gjykuar, nuk passjell detyrimisht si pasojë paragjykimin e çështjes. Sa më sipër, shkakut i ankimit i ngritur nga subjekti i rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë procesit dhe seancës dëgjimore në Komision, nuk është respektuar parimi i sigurisë juridike, i cili përfshin qartësinë, kuptueshmërinë e qëndrueshmërinë të sistemi normativ, si dhe besimin të sistemi juridik. Subjekti pretendon se shkakut kryesor i vendosur në themel të vendimmarrjes, është konstatimi si e ardhur e paligjshme e shumës së përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan, në vitin 2011, për shkak se sipas Komisionit, për këtë shumë nuk janë paguar detyrimet tatimore. Ky konstatim nuk është në përputhje me legjislacionin tatimor të kohës dhe asnjë organ ligjzbatues nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë shumë. Si rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për marrjen e masës disiplinore, është në shkelje të parimit të sigurisë juridike.

15.1 Kolegji vëren se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës, e cila presupozon, veç të tjerave, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e vazhdueshme të ligjit për marrëdhëniet e rregulluara. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin të sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore.

15.2 Gjithsesi, duke vlerësuar në tërësi rrethanat, të cilat i referohen analizës së shkakut të ankimit, duke pasur parasysh procesin e vlerësimit të pasurive personale ose familjare të krijuara gjatë jetës profesionale të subjektit të rivlerësimit, dështimin e subjektit të rivlerësimit për të paraqitur dokumente mbështetëse që vërtetojnë natyrën e ligjshme të të ardhurave të krijuara nga shitja e apartamentit në vitin 2011 dhe mosveprimi i subjektit të rivlerësimit për të deklaruar pranë organeve tatimore të ardhurat e realizuara për të përlllogaritur e paguar detyrimet tatimore, trupi

gjykues vlerësoi se nuk është konstatuar shkelje e parimit të sigurisë juridike, si rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

16. Lidhur me ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sip. 120 m², të ndodhur në Elbasan, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të shumave të marra/dhuruara nga vëllai dhe familja e bashkëshortes. Sipas subjektit të rivlerësimit, pasqyrimi i gabuar i vitit të dhënies së këtyre shumave është gabim material. Subjekti i rivlerësimit argumenton se nga analiza e Komisionit, ka rezultuar se personi tjetër i lidhur ka pasur mundësi financiare për të dhënë shumën 10.000 USD dhe ky konkluzion duhet të ishte analizuar nga Komisioni për të mos i dhënë rëndësi gabimit material të shënimit të vitit 2004, në vend të vitit 2003 në deklaratat e administruara gjatë hetimit administrativ. Sipas subjektit të rivlerësimit, shumat e përfituara nga vëllai, familjarët e bashkëshortes dhe kursimet familjare janë depozituar në llogarinë e përbashkët bankare të subjektit dhe bashkëshortes në Alpha Bank, në datën 08.09.2003 dhe janë tërhequr vetëm pak ditë para blerjes së apartamentit. Ky fakt duhet të kishte bindur Komisionin se viti i përfitimit të shumës 20.000 USD (10.000 USD nga vëllai dhe 10.000 USD nga familjarët e bashkëshortes) është viti 2003.

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se qëllimi i dhënies së këtyre shumave, në të gjitha deklaratimet e kryera, rezulton se ka qenë blerja e apartamentit në vitin 2003 dhe jo në vitin 2004. Subjekti pretendon se në jurisprudencën e Komisionit dhe të Kolegjit, deklarimi i pasaktë në deklaratimet periodike nuk është element i mjaftueshëm për të ndikuar në shkarkimin e tij nga detyra. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij në agjencinë “{***}” ShPK, në vlerën 537.500 lekë, duhen të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, pasi detyrimin për kryerjen e pagesave tatimore nuk e ka subjekti dhe as bashkëshortja e tij. Për këtë apartament, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasur mundësi financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për prenotimin e tij.

16.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë shkak ankimi: *Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer për pasurinë e llojit “apartament banimi” të prenotuar në vitin 2003 në Elbasan, për blerjen e pasurisë së llojit autoveturë, krijimin e depozitës bankare, likuiditeteve cash dhe kryerjen e shpenzimeve të evidentuara nga Komisioni dhe të vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit, pasuri të krijuara dhe shpenzime të kryera deri në datë 31.12.2003.*

16.2 Në deklaratën vetting, subjekti ka deklaruar: *Apartament me sipërfaqe 110,2 m² në rezidencën “{***}”, {***}, blerë sipas kontratës për ndërtim apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë, 21.10.2011. Aktualisht apartamenti nuk është me certifikatë pronësie dhe burimi i blerjes së këtij apartamenti është si rezultat i shitjes së dy apartamenteve 1+1, të modifikuar në një apartament, me sip. totale 120 m², në Elbasan, sipas aktmarrëveshjes, datë 25.03.2011, në vlerën 12.500.000 lekë, i cili është blerë sipas aktmarrëveshjes, datë 05.12.2003, në vlerën e 4.000.000 lekëve.*

Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Hyrje 1+1, apartament, ndërtuar para vitit 1990, bashkëpjesëtar me familjen, pjesa zotëruese 25%, privatizuar nga shteti.*

Depozitë bankare në emër të bashkëshortes M. M., bono thesari [...] 0,5 milionë lekë të reja, me burim krijimi nga kursimet.

Gjendje cash (në shtëpi) [...] 2,5 milionë lekë të reja, nga kursimet.

Në Deklaratën e Interesave Periodikë Privatë (në vijim “DIPP”) të vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 120 m², 2+1, në ndërtim e sipër, me burim 10.000 USD nga vëllai për shkak të heqjes dorë nga pronësia, +10.000 USD të ardhura nga familja e bashkëshortes. Vlera e apartamentit 3.300.000 lekë.*

*Autoveturë “Benz-Mercedes”, me targë {***}, me vlerë 250.000 lekë.*

Pakësim i gjendjes së cash-it, për blerjen e shtëpisë me vlerë 2.500.000 lekë.

16.3 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, konstatohet se me kontratën⁵ “Për ndërtim apartamenti”, të datës 21.10.2011, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë porositur nga shoqëria “{***}” ShPK, apartamentin me sipërfaqe 110,2 m², në objektin e ndërtuar nga kjo shoqëri në adresën: rezidenca “{***}”, {***}, Tiranë. Në nenin 3 të kësaj kontrate, përcaktohet se vlera totale e shitjes së këtij apartamenti është 58.406 euro dhe se kjo vlerë do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate.

Gjithashtu, rezulton se më datë 25.10.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë nënshkruar kontratën⁶ e shitblerjes së këtij apartamenti me shoqërinë “{***}” ShPK. Referuar kësaj kontrate, në nenin 2 të saj parashikohet se çmimi i blerjes së këtij apartamenti është likuiduar mes tyre në ekzekutim të të drejtave dhe detyrimeve të kontratës së datës 21.10.2011 (kontrata për ndërtim apartamenti).

16.4 Meqenëse subjekti i rivlerësimit për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 110,2 m² te rezidenca “{***}”, Tiranë, ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Elbasan, me sipërfaqe 120 m², Komisioni ka marrë në analizë këtë të fundit për mundësinë e krijimit të tij me burime financiare të ligjshme. Ky apartament, sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, ishte i modifikuar, pasi dy hyrje 1+1 janë bashkuar në një të vetme, me sip. totale 120 m², ndodhur në anën veriore të Bankës Kombëtare Tregtare, Elbasan, porositur sipas aktmarrëveshjes⁷, datë 05.12.2003, në vlerën 4.000.000 lekë -dhe shitur nëpërmjet aktmarrëveshjes⁸, datë 25.03.2011, në vlerën 12.500.000 lekë. Ky apartament nuk ka qenë i regjistruar në momentin e blerjes nga subjekti i rivlerësimit, gjithashtu as në momentin e shitjes së tij. Në aktmarrëveshjen e datës 05.12.2003, të lidhur ndërmjet shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK dhe Alket e M. Mersinit, parashikohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, ditën e nënshkrimit, kanë likuiduar *cash* përfaqësuesit e shoqërisë, në vlerën 3.000.000 lekë, si pagesë e

⁵ Kontratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.10.2011.

⁶ Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.2017.

⁷ Nënshkruar para noterit sipas vërtetimit të nënshkrimit nr. {***} rep., datë 05.12.2003.

⁸ Nënshkruar para noterit sipas vërtetimit të nënshkrimit nr. {***} rep., datë 25.03.2011.

këstit të parë të pagesës dhe pas përfundimit të ndërtimit të apartamentit dhe marrjes në dorëzim, do të likuidonin pjesën e mbetur.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton deklarata noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 22.12.2003, nëpërmjet së cilës Alket dhe M. Mersini deklarojnë se i kanë paguar z. E. K., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, shumën prej 1.000.000 lekësh, e cila përbën edhe pagesën e këstit të fundit të blerjes së apartamentit.

16.5 Kolegji vëren se në DIPP-në e vitit 2004, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 120 m², në ndërtim e sipër, me vlerë 3.300.000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie, ka deklaruar: (i) 10.000 USD të dhëna nga vëllai prej heqjes dorë nga bashkëpronësia në shtëpinë e prindërve; dhe (ii) 10.000 USD të ardhura nga familja e bashkëshortes. Si rrjedhojë e kësaj mospërputhjeje të konstatuar ndërmjet çmimit të blerjes së kësaj pasurie të deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 dhe atij të përcaktuar në aktmarrëveshjen për ndërtim apartamenti të datës 05.12.2003, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, pyeti subjektin e rivlerësimit, i cili në përgjigje sqaroi se është gabim material, pasi në deklarim është shënuar 3.300.000 lekë, kur në realitet duhej të shënohej 33.000 USD dhe se likuidimi i çmimit të apartamentit është kryer në USD.

16.6 Komisioni gjithashtu pyeti subjektin e rivlerësimit edhe për burimin e krijimit të kësaj pasurie, ku përveç deklarimit të tij të bërë në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit sqaroi se burimet e të ardhurave për pagesën e shumës 4.000.000 lekë, janë: (i) kursimet nga të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes; (ii) të ardhurat nga shitja e shtëpisë në vitin 2000, në vlerën 1.900.000 lekë; (iii) dhurimi i shumës 10.000 USD (\approx 1.210.000 lekë) nga familja e bashkëshortes; (iv) pagesë e dhënë, prej 10.000 USD (\approx 1.210.000 lekë), nga vëllai në këmbim të pjesës së tij takuese, në apartamentin e privatizuar në vitin 1993 së bashku me prindërit, banesë në të cilën subjekti sqaroi se ka jetuar edhe vetë deri në vitin 2001; dhe (v) të ardhurat e bashkëshortes së subjektit nga projekti “{***}” me Universitetin “{***}”, Elbasan, në prill 2003 – shkurt 2004, në shumën 490 euro \times 140 lekë/euro \approx 68.000 lekë.

16.7 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, i pyetur për burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në datën 28.07.2000, në Elbasan (shitja e të cilit ka shërbyer si burim për pagesën e shumës 4.000.000 lekë për blerjen e apartamentit 120 m²), përveç të ardhurave të deklaruara në deklaratën *vetting*, pretendoi të ardhura të tjera të përfituara nga punësimi i bashkëshortes së tij ndër vite (kryesisht para vitit 2003), të cilat konsistojnë në pjesëmarrje në projekte të ndryshme, si dhe të ardhura të pretenduara si të kursyera nga bursat e studimit. Me dërgimin e shpjegimeve për rezultatet e hetimit të Komisionit, subjekti pretendoi të përfshihen në analizën financiare për pasuritë e krijuara prej tij dhe bashkëshortes deri në datë 31.12.2003, të ardhura shtesë të përfituara nga puna e saj në agjencinë “{***}” ShPK, pjesëmarrje në projektin “{***}”, si edhe të ardhura nga bursat e studimit. Si rrjedhojë, çështjet që i nënshtrohen vlerësimit në Kolegj janë të ardhurat e pretenduara të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, të cilat janë deklaruar gjatë procesit administrativ, si dhe përfshirja ose jo në analizën financiare e 20.000 USD të dhëna nga vjehrra dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, përkatësisht nga 10.000 USD secili, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi.

16.8 Sa u përket të ardhurave të krijuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerësoi të mos i marrë në konsideratë, pasi janë të paprovuara me dokumente ligjore, si për sa i përket përfitimit të tyre, ashtu edhe përmbushjes së detyrimeve tatimore, duke mbetur pretendimet e subjektit në nivel deklarativ dhe, si rrjedhojë, nuk përmbushin kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Komisioni konkludoi se vlerat monetare të përfituara nga bursa shërbejnë për shpenzime të shkollimit të bashkëshortes së subjektit dhe nuk mund të reflektohen si të ardhura e aq më tepër, si burim i krijimit të pasurive. Subjekti i rivlerësimit, me dokumentacionin e dorëzuar bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, ka paraqitur vërtetimin e datës 12.02.2020, lëshuar nga agjencia “{***}” ShPK, sipas të cilit znj. M. M. ka qenë punonjëse pranë kësaj agjencie, në pozicionin nëpunës në agjenci udhëtimesh për periudhën 24.08.1997 – 15.06.1999, me pagë mujore neto prej 25.000 lekësh. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se i është kërkuar informacion⁹ Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë (dokument i administruar në dosjen e Komisionit), për shtetasen M. M. (Z.), nëse janë paguar sigurimet shoqërore nga agjencia “{***}” ShPK për periudhën e mësipërme, por ky institucion nuk ka kthyer përgjigje.

16.9 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se Komisioni i është drejtuar me shkresë¹⁰ Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (në vijim “DPT”), nëpërmjet së cilës i kërkon informacion lidhur me të dhënat tatimore për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. DPT-ja në përgjigjen¹¹ e saj drejtuar Komisionit, ka sqaruar se nga verifikimet e kryera, asnjë nga shtetasit e cituar në shkresën e Komisionit, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat. Gjithashtu në këtë informacion sqarohet se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij figurojnë të regjistruar si subjekte deklaruese të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA). Në dokumentet e administruara në dosjen e Komisionit, nuk rezulton kontratë pune apo të dhëna të tjera lidhur me faktin nëse bashkëshortja e subjektit ka punuar në këtë agjenci si dhe nëse po, a janë paguar apo jo detyrimet tatimore për të ardhurat e krijuara nga puna e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në agjencinë “{***}” ShPK, sipas deklaramentit të subjektit gjatë hetimit administrativ.

16.10 Subjekti i rivlerësimit në ankim ka shpjeguar se është detyrim i punëdhënësit të zbrësë nga paga dhe të paguajë në organet përgjegjëse tatimin mbi të ardhurat dhe kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, dhe nuk është përgjegjësi e punëmarrësit mospërmbushja e këtij detyrimi. Trupi gjykues vlerëson se ky shpjegim nuk ndikon në një interpretim të ndryshëm të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nga sa është interpretuar tashmë dhe ka gjetur pasqyrim në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, mbi ligjshmërinë e të ardhurave dhe detyrimin kushtetues të përmbushjes së detyrimeve përkatëse tatimore. Për këto të ardhura nuk gjendet dokumentacion i administruar në dosje, përveç vërtetimit të lëshuar gjatë hetimit administrativ nga agjencia, ku subjekti pretendon se ka punuar bashkëshortja e tij, duke mos krijuar

⁹ Me kërkesën e protokolluar në DRSSH Tiranë me nr. {***} prot., datë 27.07.2020.

¹⁰ Nr. {***} prot., datë 11.09.2019.

¹¹ Nr. {***} prot., datë 24.09.2019.

qartësi: (i) nëse janë paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e pretenduara, si dhe (ii) nëse këto detyrime tatimore nuk janë paguar, a ishte në kushtet e mirëbesimit apo në kushtet e keqbesimit bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, pra nëse kishte dijeni që nuk i paguheshin detyrimet tatimore dhe pajtohej me këtë fakt. Si rrjedhojë e sa më sipër, për të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të përfituara nga puna e bashkëshortes së tij në agjencinë “{***}” ShPK, në dosje nuk gjendet dokumentacion i cili të provojë ekzistencën e kësaj marrëdhënieje pune sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, situatë e cila do të qartësonte edhe trupin gjykues lidhur me detyrimin për pagesën e tatimit si rezultat i përfitimit të këtyre të ardhurave. Për këtë arsye, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë qëndrimin e Komisionit se këto të ardhura të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të krijuara nga puna e bashkëshortes së tij në agjencinë “{***}” ShPK, të mos përfshihen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

16.11 Lidhur me shumën prej 10.000 USD, të deklaruar si të dhënë nga vëllai i subjektit të rivlerësimit për shkak të heqjes dorë nga bashkëpronësia e apartamentit në Elbasan, si dhe shuma prej 10.000 USD e deklaruar si e dhuruar nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se vëllai i subjektit të rivlerësimit dhe prindërit e bashkëshortes bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të vëllait të tij dhe familjarëve të bashkëshortes, të cilat kanë shërbyer për krijimin e vlerave monetare të dhëna prej tyre në favor të subjektit dhe bashkëshortes së tij për blerjen e apartamentit.

16.12 Lidhur me burimin e krijimit të shumës së dhënë nga vëllai, subjekti i rivlerësimit, me deklaratën *vetting*, ka depozituar dokumentacion provues, për të cilin Komisioni vlerësoi se z. E. M., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës 10.000 USD, të deklaruar si e dhënë në favor të subjektit të rivlerësimit për shkak të bashkëpronësisë së apartamentit të përfituar nëpërmjet ligjit të privatizimit, duke i konsideruar bindëse shpjegimet e subjektit në deklarinë e bërë në DIPP-në e vitit 2004 për shumën e përfituar nga vëllai, si rezultat i heqjes dorë të subjektit nga pasuria në bashkëpronësi. Gjithashtu, lidhur me mundësinë financiare të familjarëve të bashkëshortes për krijimin e shumës prej 10.000 USD, dhënë vajzës së tyre, Komisioni, bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, krijoi bindjen se familjarët e bashkëshortes së subjektit kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e shumës prej 10.000 USD, të pretenduar si të marrë nga subjekti dhe personi i lidhur në vitin 2003, deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2004.

16.13 Lidhur me momentin e marrjes në dorëzim të dy vlerave monetare të dhëna/dhuruara nga familjarët, Komisioni konkludoi se nuk janë bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti lidhur me pasaktësinë e deklaratave të personave të tjerë të lidhur dhe, si rrjedhojë, këto dy vlera monetare (në total, vlera prej 20.000 USD) nuk i ka konsideruar si burim krijimi të pasurisë së llojit “apartament”, të porositur nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2003, duke mos i përfshirë në analizën

financiare të kryer nga Komisioni për të gjitha pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur deri më 31.12.2003.

16.14 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në deklarin e parë të pasurisë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasurinë “apartament banimi 120 m²”, gjithashtu nuk janë deklaruar edhe vlerat monetare të pretenduara si të dhëna nga vëllai i subjektit dhe familjarët e bashkëshortes, që sipas pretendimit të subjektit, janë përfituar në vitin 2003. Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti deklaroi për herë të parë këtë pasuri dhe, referuar dokumentacionit ligjor të administruar në fashikullin e Komisionit, rezulton se apartamenti është prenotuar dhe është paguar shuma e plotë prej 4.000.000 lekësh që në vitin 2003.

16.15 Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i kërkoi sqarime subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në vitin 2003, si dhe për mënyrën si e ka marrë shumën 20.000 USD nga vëllai dhe prindërit e bashkëshortes. Në përgjigje të këtij pyetësori, datë 14.02.2020, subjekti i rivlerësimit sqaroi se: *Deklarata e datës 19.03.2004 është plotësuar për herë të parë sapo kishte hyrë në fuqi dhe filluar të zbatohej ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.* Akoma nuk ishte e qartë se çfarë dhe si duhej të plotësohej kjo deklaratë. [...] *Vlera është dhuruar cash, vlerë të cilën pas dhurimit, e kemi depozituar në llogarinë bankare, të përbashkët me bashkëshorten, në vitin 2003. Burimi i të ardhurave të tyre janë kursimet nga puna ndër vite.*

16.16 Bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision një deklaratë të vëllait E. M., e cila nuk ka datën e nënshkrimit dhe nuk është hartuar para noterit. Sipas kësaj deklarate, E. M. i ka dhënë vëllait të tij, subjektit të rivlerësimit, shumën 10.000 USD, në vitin 2004, kundrejt heqjes dorë nga pronësia për apartamentin e ndodhur në Elbasan. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit dorëzoi edhe deklaratën e vjehrrës së tij H. Z., sërish pa datën e nënshkrimit dhe jo e hartuar para noterit, në të cilën deklaruesja sqaron se i kanë dhuruar vajzës së tyre në vitin 2004 shumën 10.000 USD, si ndihmë për apartamentin e blerë së bashku me bashkëshortin e saj (subjektin e rivlerësimit). Pavarësisht këtyre deklaratave, subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ pretendoi se këto shuma janë dhënë në vitin 2003, vit në të cilin është blerë pasuria, por nga ana tjetër, vetë subjekti e ka deklaruar blerjen e apartamentit për herë të parë në DIPP-në e vitit 2004. Gjithashtu, në deklaratën *vetting* rezulton se subjekti i rivlerësimit, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, ka deklaruar: *Të ardhura në vitin 2004 nga heqja dorë nga bashkëpronësia në apartamentin 1+1 [...] Elbasan, dhënë nga vëllai E. M. sipas deklaratës së lëshuar prej tij [...] në shumën 10.000 USD.* Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, po ashtu në deklaratën *vetting*, në të njëjtën rubrikë, ka deklaruar: “Të ardhura në vitin 2004, të dhuruara nga prindërit e M. M. (Z.), si ndihmë për blerjen e shtëpisë së re prej saj dhe bashkëshortit, të krijuara nga kursimet ndër vite të familjes Z.. Shuma e të ardhurave 10.000 USD”. Në këtë situatë faktike, rezulton se ka mospërputhje lidhur me momentin e përfitimit të shumave, mes pretendimeve të subjektit të rivlerësimit dhe informacionit që rezulton sipas dokumentacionit të administruar në dosje. Ndërsa subjekti i rivlerësimit pretendon se momenti i marrjes së këtyre shumave përkon me momentin e blerjes së apartamentit në vitin 2003, sipas deklaratave të të afërmeve të tij dhe bashkëshortes, deklarimit periodik të vitit

2004 të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar deklaramit të këtyre të ardhurave në deklaratën *vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, rezulton se ndihma prej 20.000 USD nga të afërmit është dhënë në vitin 2004.

16.17 Kolegji vëren se në dokumentacionin e dosjes, rezulton e administruar deklarata noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 22.12.2003, sipas së cilës Alket dhe M. Mersini deklarojnë se i kanë paguar E. K., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, shumën prej 1.000.000 lekësh, që përbën edhe pagesën e kështit të fundit për blerjen e apartamentit, si dhe në të njëjtën deklaratë E. K.deklaron se ka marrë kështin e fundit prej 1.000.000 lekësh nga Alket e M. Mersini, si kësht i fundit për shlyerjen e apartamentit të porositur. Gjithashtu, bashkë me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision dy deklarata noteriale: (i) deklarata me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., të datës 21.08.2020, lëshuar nga vëllai i tij E. M., i cili sqaron se ka dhënë shumën 10.000 USD, në këmbim të heqjes dorë nga ana e subjektit të rivlerësimit prej pasurisë së përbashkët, apartamentit të përfituar nga ligji i privatizimit. Vëllai i subjektit deklaron se e ka dhënë këtë shumë parash gjatë vitit 2003; (ii) deklarata tjetër noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.08.2020, e lëshuar nga vjehrra e subjektit të rivlerësimit, znj. H. Z., e cila deklaron se i ka dhuruar vajzës së saj shumën prej 10.000 USD në vitin 2003 dhe se gabimisht ka deklaruar se e ka dhënë këtë shumë në vitin 2004.

16.18 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se të ardhurat e përfituara nga vëllai dhe nga familjarët e bashkëshortes së tij janë depozituar në Alpha Bank, në datën 09.05.2003.

Në dokumentacionin e administruar në dosje, gjendet pasqyra e llogarive bankare në lekë dhe në USD në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, të cilat janë dorëzuar gjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit. Nga përmbajtja e llogarisë bankare në Alpha Bank, rezulton se në datën 09.05.2003, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë depozituar shumën 2.800.000 lekë, të cilat janë kaluar në depozitë. Në datën 01.07.2003, është depozituar prej tyre shuma 900.000 lekë dhe në datën 29.07.2003, është depozituar shuma 1.100.000 lekë, të dyja këto shuma janë kaluar në depozitë.

Në llogarinë bankare në USD në Alpha Bank të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, në datën 05.12.2003 është tërhequr shuma prej 24.690 USD, ndërsa në datën 22.12.2003 është tërhequr shuma 8.230 USD. Totali i këtyre tërheqjeve bën shumën 32.920 USD, të cilat, të konvertuara me kursin mesatar të muajit dhjetor të vitit 2003, do të rezultojnë në shumën 3.578.074 lekë. Në lidhje me krijimin e kësaj depozite, nuk mund të verifikohet nëse si burim i krijimit të saj kanë shërbyer edhe dhurimet nga familjarët, për sa kohë nuk ka dokumentacion provues për datën e saktë të dhënies së shumave, përveçse deklaratave personale në formën e shkresës së thjeshtë, të të cilat referohen dy shumat me nga 10.000 USD secila, si të dhëna/dhuruara në vitin 2004.

16.19 Nga sa u analizua më sipër, Kolegjit i rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ka paguar apartamentin në vitin 2003, dhe se kësht i fundit prej 1.000.000 lekësh është paguar në muajin dhjetor të këtij viti, sipas deklaratës noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 22.12.2003, e cila rezulton të jetë nënshkruar në kohën kur është kryer pagesa. Dokumentacioni i administruar në dosje nuk provon se janë dhënë/dhuruara shumat prej 10.000 USD nga të afërmit e subjektit dhe bashkëshortes së tij, para shlyerjes së çmimit të kontratës.

16.20 Në përfundim të analizës së shkakut të trajtuar më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shumat e dhëna nga familjarët si ndihmë për blerjen e apartamentit në Elbasan, mbetën në nivel deklarativ sa i përket momentit të përfitimit, për rrjedhojë trupi gjykues nuk krijoi bindjen se këto shuma monetare janë dhënë në vitin 2003, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, kjo edhe për faktin se në deklaratën *vetting* të dorëzuar më datë 26.01.2017, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar që këto të ardhura janë përfituar nga të afërmit në vitin 2004, deklarim ky që përputhet me atë periodik të vitit 2004, si dhe deklaratat me shkrim të të afërmeve. Gjithashtu, lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga puna në agjencinë “{***}” ShPK, nuk u provua me dokumentacion ligjor fakti që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka punuar pranë kësaj agjencie. Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion për të provuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje pune, prej së cilës pretendon se janë krijuar të ardhurat e bashkëshortes, si dhe në mungesë të informacionit lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, u mjaftua vetëm me paraqitjen e një vërtetimi të lëshuar nga kjo agjenci gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Për rrjedhojë, trupi gjykues, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, vlerësoi se të ardhurat e pretenduara nga ndihma e familjarëve dhe punësimi i bashkëshortes mbetën në nivel deklarativ, duke e gjetur të bazuar konkluzionin e Komisionit për të mos i përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Nga kontrolli që ushtroi Kolegji në analizën financiare të kryer në Komision për periudhën 1996-2003, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ishte në pamundësi financiare për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve me të ardhura nga burime financiare të ligjshme, për diferencën negative në shumën -2.417.454 lekë, në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 17. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit** me sip. 120 m², në Elbasan, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se për të ardhurat e krijuara nga shitja e të drejtave reale mbi këtë pasuri në vitin 2011, si diferencë e këtij çmimi me atë të paguar për porositjen e kësaj pasurie në vitin 2003, subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin dhe pagimin e detyrimeve tatimore. Subjekti pretendon se Komisioni ka anashkaluar përgjigjen e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në përgjigje të kërimit të informacionit nga Komisioni, në të cilën nuk konstatohej se për këtë të ardhur të krijuar, duhet të paguhet detyrime tatimore. Subjekti pretendon se Komisioni në mënyrë të qëllimshme, për të rënduar pozitën e subjektit, i referohet legjislacionit tatimor, njëjloj sikur pasuria e subjektit të ishte e regjistruar në regjistrat publikë, edhe pse kjo e fundit nuk ishte e regjistruar në momentin e shitjes. Sipas subjektit të rivlerësimit, nëse të ardhurat e përfituara nga transferimi i të drejtave reale do ishin të tatueshme, nuk kishte pse të miratoheshin ndryshimet ligjore me ligjin nr. 94/2018, datë 03.12.2018, nëpërmjet të cilave u ndryshua pika “dh” e nenit 4 të ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, duke u përfshirë në të ardhurat e tatueshme edhe ato që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme, pa u kufizuar vetëm në të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat e pronësisë. Në përfundim të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni,

e ardhura e përfitur nga shitja e apartamentit në vitin 2011, duhet të konsiderohet si e ligjshme dhe të përfshihet në analizën financiare.

17.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje: *Trupi gjykues çmon se të ardhurat shtesë (diferenca midis çmimit të dokumentuar të shitjes së të drejtave mbi këtë pasuri në vitin 2011 me çmimin e dokumentuar të paguar për prenotimin/porositjen e kësaj pasurie në vitin 2003), të përfituara prej subjektit dhe personit të lidhur nga transferimi i të drejtave reale mbi pasurinë e sipërcituar, nuk përmbushin kushtet e parashikuara në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Si të tilla, ato nuk do të përfshihen në analizën financiare si burim i ligjshëm i krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.*

17.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament me sipërfaqe 110,2 m² në rezidencën “{***}”, {***}, blerë sipas kontratës për ndërtim apartamenti me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.10.2011. Aktualisht apartamenti nuk është me certifikatë pronësie dhe burimi i blerjes së këtij apartamenti është si rezultat i shitjes së dy apartamenteve 1+1, të adoptuar në një apartament, me sip. totale 120 m², në anën veriore të BKT Elbasan, sipas aktmarrëveshjes, datë 25.03.2011, në vlerën 12.500.000 lekë, i cili ishte blerë sipas aktmarrëveshjes, datë 05.12.2003, në vlerën e 4.000.000 lekëve”.

Në lidhje me investimin në bono thesari, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*, ka deklaruar: “Gjendje bono thesari në datë 20.01.2017, pranë Bankës së Shqipërisë, në emër të M. M. [...]. Burimi i kësaj gjendje lekësh në bono thesari, është si rezultat i diferencës së krijuar nga shitja e dy apartamenteve 1+1, të adoptuar në një apartament, me sip. totale 120 m², në anën veriore të BKT Elbasan, sipas aktmarrëveshjes, datë 25.03.2011, në vlerën 12.500.000 lekë dhe blerjes së apartamentit 110,2 m² në rezidencën “{***}”, Tiranë, sipas kontratës me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.10.2011, në shumën prej 58.406 eurosh, si dhe kursimet nga pagat ndër vite dhe interesat bankarë të përfitur. Shuma 7.000.000 lekë, pjesa takuese 100%”.

17.3 Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Hyrje 1+1, apartament i ndërtuar para vitit 1990, bashkëpjesëtar me familjen, pjesa zotëruese 25%, përfitur nga privatizimi.*

Depozitë bankare në emër të bashkëshortes M. M., bono thesari, vlera 0,5 milionë lekë të reja, me burim nga kursimet.

Gjendje cash (në shtëpi) 2,5 milionë lekë të reja nga kursimet.

Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar veprime që lidhen me blerjen e pasurisë në rezidencën “{***}”, Tiranë, ndërsa bashkëshortja e tij ka deklaruar në rubrikën e pasurive në këtë deklaratë: *Tërhequr nga llogaria bankare në Alfa Bank, dega Elbasan, në emër të M. M., me afat 1-vjeçar, depozituar në shtator 2009 (kursime të mbledhura nga pagat e viteve +2009) shuma prej 2.100.000 për prenotimin e një shtëpie në rezidencën “{***}” në Tiranë.*

Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Aktmarrëveshje e datës 25.03.2011, për shitjen e një shtëpie banimi me sipërfaqe 120 m², në Elbasan, lidhur para noterës A. B., në*

vlerën e 12.500.000 lekëve, ku 12.300.000 janë derdhur në llogari të M. M., me nr. {***}, në Alfa Bank dhe 200.000 janë likuiduar cash.

Kontratë për ndërtimin e një apartamenti nr. {***} rep., e {***} kol., datë 21.10.2011, te rezidenca “{***}” me kompaninë e ndërtimit “{***}” ShPK, para noteres M. S, Tiranë, me sipërfaqe 110,2 m² dhe çmim total 58.406 euro, e likuiduar.

Në lidhje me investimin në bono thesari, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar: Depozituar bono thesari në Bankën e Shqipërisë, me maturim njëvjeçar, me numër llogarie {***}, në emër të M. M., nga data 13.10.2011 deri më 11.10.2012, vlera 4.700.000 lekë. Burimi i kësaj depozite nuk është deklaruar.

17.4 Siç është shpjeguar edhe më sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka porositur dy apartamente 1+1, të cilët janë bashkuar në një të vetëm, me sip. totale 120 m², ndodhur në anën veriore të Bankës Kombëtare Tregtare, Elbasan, porositur sipas aktmarrëveshjes, datë 05.12.2003, në vlerën 4.000.000 lekë. Këto dy apartamente të bashkuara në një të vetëm, subjekti i rivlerësimit i ka shitur nëpërmjet aktmarrëveshjes, datë 25.03.2011, në vlerën 12.500.000 lekë. Arsyeja që subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë apartament me aktmarrëveshje dhe jo me kontratë shitjeje, konsiston në mungesën e regjistrimit dhe certifikimit të kësaj pasurie në ZVRPP Elbasan. Komisioni i ka kërkuar informacion¹² shoqërisë së ndërtimit “{***}” ShPK, në lidhje me momentin kur është regjistruar kjo pronë në emër të shoqërisë, nëse shoqëria ka dhënë pëlqimin e saj për kalimin e të drejtave të pronësisë sipas marrëveshjes së datës 25.03.2011, dhe nëse është nënshkruar kontrata përfundimtare e shitjes së kësaj pasurie. Shoqëria “{***}” ShPK i ka kthyer përgjigje¹³ Komisionit se pasuria me nr. {***}, ndodhur në zonën kadastrale {***}, Elbasan, është regjistruar më datë 15.10.2014, në emër të individit E. M. K., administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, dhe kjo pasuri u është shitur shtetasve H. A. dhe N. A. (të njëjtët persona që kanë blerë apartamentin me sip. 120 m² në vitin 2011, subjektit të rivlerësimit) sipas kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 09.02.2015.

17.5 Kolegji vëren se si pasojë e kalimit të të drejtave mbi apartamentin nëpërmjet aktmarrëveshjes, datë 25.03.2011, subjekti i rivlerësimit ka krijuar të ardhura për të cilat nuk ka paguar detyrimet tatimore, me pretendimin se nuk e ka pasur një detyrim të tillë për arsye se nuk parashikohet shprehimisht në ligj tatim për kalimin e të drejtave reale të pronësisë. Me të ardhurat e krijuara nga kjo shitje, subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin me sip. 110 m² në rezidencën “{***}”, Tiranë me çmim 58.000 euro, si dhe ka investuar në bono thesari, duke krijuar depozitë me maturim njëvjeçar, për shumën 4.700.000 lekë. Për të ardhurat që ka krijuar subjekti i rivlerësimit prej diferencës pozitive nga shitja në blerje e këtij apartamenti, Komisioni, për shkak se nuk janë paguar detyrimet tatimore, nuk i ka konsideruar si të ardhura të krijuara me burime financiare të ligjshme.

17.6 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet aktmarrëveshjes, datë 25.03.2011, e ka shitur këtë apartament në vitin

¹² Me shkresën nr. {***} prot., datë 29.04.2020.

¹³ Me shkresën e datës 15.05.2020.

2011, në vlerën 12.500.000 lekë, në një kohë që e ka blerë në vitin 2003 për çmimin 4.000.000 lekë, në gjendjen karabina dhe, sipas shpjegimeve të tij në pyetësorin nr. 2 të Komisionit, subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar në vitin 2004 shumën *cash* prej 2.5000.000 lekë, të kursyer ndër vite për përfundimin e punimeve të apartamentit. Subjekti i rivlerësimit depozitoi në Komision deklaratën noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., të datës 08.02.2020, ku z. E. K., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, deklaroi se i ka dhënë për vlerën 4.000.000 lekë, me aktmarrëveshje, z. Alket Mersini, një sipërfaqe ndërtimi prej 120 m², të llojit “apartament” dhe se kjo pronë e marrë në dorëzim nga z. Alket Mersini në vitin 2003, ka qenë në fazë karabina, ku ka pasur vetëm derën e blinduar dhe të gjitha punimet e brendshme u morën përsipër për t’u kryer me shpenzimet e veta. Edhe në aktmarrëveshjen e datës 05.12.2003, është parashikuar se shtrimi me pllaka i ambienteve të brendshme do të përballohet nga vetë blerësi. Komisioni i ka përllogaritur subjektit të rivlerësimit shpenzime për përfundimin e këtij apartamenti, si dhe arredimin e tij, duke i përcaktuar si çmim përfundimtar shumën 7.700.000 lekë.

17.7 Komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për t’i kërkuar informacion/interpretim se a kanë bërë pjesë në të ardhurat e tatueshme për vitin 2011, të ardhurat e realizuara nga individit si rezultat i transferimit të të drejtave për një pasuri të paluajtshme të paregjistruar në regjistrat publikë, dhe mbi çfarë dokumentacioni do vlerësoheshin të ardhurat mbi bazën e të cilave do duhej të llogaritej/paguhej tatimi. Nëse po, cila ka qenë mënyra e deklarimit dhe forma e pagesës që do duhej të kryhej pranë organit tatimor në këtë vit. DPT-ja, në përgjigjen¹⁴ e saj drejtuar Komisionit, ka sqaruar se diferenca pozitive ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë së paluajtshme përbën “fitimin kapital të realizuar”, i cili në vitin 2011, si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë, është tatuar me normën 10%. Më tej, në këtë shkresë, sqarohet se tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të saj, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Siç vërehet në përgjigjen e DPT-së drejtuar Komisionit, nuk u janë dhënë përgjigje kërkesave për të cilat ka kërkuar informacion ky i fundit, por ka sqaruar mënyrën e pagimit të tatimit nga fitimi i realizuar nga shitja e pasurive të paluajtshme, kategori nga e cila subjekti i rivlerësimit e përjashton veten.

17.8 Kolegji vëren se në aktmarrëveshjen, datë 25.03.2011, me anë të së cilës i është kaluar pasuria apartament me sip. 110 m² blerësve A., nuk është përfshirë shoqëria “{***}” ShPK si palë në kontratë, por është lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit e bashkëshortes së tij, si dhe H. e N. A.. Palët kanë rënë dakord për pagesën dhe mënyrën e kryerjes së saj në aktmarrëveshje, sipas së cilës është cituar se pagesa totale për blerjen e ambientit të porositur nga z. H. A. dhe znj. N. A., është në shumën 12.500.000 lekë. Në datën e nënshkrimit të aktmarrëveshjes, është paguar shuma 12.300.000 lekë në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit në Alpha Bank, ndërsa shuma prej 200.000 lekësh do të likuidohej brenda muajit korrik 2011. Në aktmarrëveshje janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, prej të cilave subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në

¹⁴ Shkresë e DPT-së nr. {***}, datë 18.05.2020.

dorëzimin përfundimtar të objektit, mbështesin me dokumentacion porositësin për të realizuar kontratën e shitblerjes dhe hipotekimin e ambienteve të prenotuara. Ndërsa pala tjetër, H. e N. A. merr përsipër të kryejë pagesën, të marrë në dorëzim ambientin, si dhe të likuideojë kontratën e shitjes, akt ky që do të nënshkruhej nga të dy palët pas dorëzimit përfundimtar të ambientit. Sipas kushteve të kësaj aktmarrëveshjeje, Kolegji vëren se pavarësisht nga terminologjia e përdorur në kontratë, nga përmbajtja e saj rezulton e qartë se qëllimi i saj ishte shitja nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij në favor të palës tjetër të apartamentit me sip. 120 m², kundrejt çmimit të përcaktuar në këtë aktmarrëveshje, prej 12.500.000 lekësh, për të cilin kishin dakordësuar edhe mënyrën e shlyerjes.

17.9 Kolegji sjell në vëmendje se kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi, ose kalimin e një të drejte, kundrejt pagimit të një çmimi. Në nenin 83 të Kodit Civil, parashikohet: *Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm [...].* Në këtë kontekst, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka kaluar të drejta reale nëpërmjet aktmarrëveshjes, por në fakt kjo e fundit, pavarësisht se nuk është lidhur në mënyrën e kërkuar nga neni 83 i Kodit Civil, ka qartazi tiparet e një kontrate shitjeje, ku pala shitëse dorëzon sendin, duke hequr dorë përfundimisht prej tij, kundrejt marrjes së pagesës nga blerësi. Nga kjo aktmarrëveshje, subjekti i rivlerësimit ka gjeneruar një diferencë pozitive nga blerja (4.000.000 lekë) në shitje (12.500.000 lekë), për të cilën nuk rezulton se ka paguar detyrime tatimore, me pretendimin se nuk e kishte një detyrim të tillë të shprehur në ligj.

17.10 Në analizë të situatës faktike, rezulton se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet aktmarrëveshjes së vitit 2011, e ka shitur apartamentin, pra ka shitur pronën e tij dhe jo të drejtat reale, siç pretendon ai në ankim. Subjekti i rivlerësimit ka banuar në atë apartament që nga viti 2004 dhe e ka paguar tërësisht vlerën e blerjes prej 4.000.000 lekësh në vitin 2003, çmim i dakordësuar me shoqërinë ndërtuese për blerjen e apartamentit. Neni 149 i Kodit Civil parashikon: *Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji.* Në rastin e subjektit të rivlerësimit, apartamenti është blerë në vitin 2003 nëpërmjet aktmarrëveshjes, për shkak se nuk mund të lidhnin me shoqërinë ndërtuese kontratë shitjeje, pasi pasuria ishte e paregjistruar dhe e tillë ka mbetur deri në vitin 2014. Subjekti i ka paguar çmimin e dakordësuar shoqërisë ndërtuese dhe është bërë pronar *de facto* i apartamentit. Subjekti i rivlerësimit e ka poseduar, gëzuar, madje dhe disponuar lirisht pasurinë e paluajtshme apartament banimi, të ndodhur në Elbasan, pasi me aktmarrëveshjen e vitit 2011, e ka shitur me një çmim shumë më të lartë se çmimi që e ka blerë këtë apartament në vitin 2003, si dhe çmimi i blerjes (58.000 euro) së apartamentit në Tiranë, te “{***}”, me sipërfaqe (110 m²) thujse të njëjtë, çka provon se subjekti i rivlerësimit është sjellë si pronar, duke e disponuar lirisht apartamentin prej 120 m². Shitja e pasurisë nga subjekti i rivlerësimit, është realizuar me aktmarrëveshje, duke qenë i kushtëzuar nga pamundësia objektive për ta realizuar me kontratë shitblerjeje, pasi prona ishte e paregjistruar nga shoqëria ndërtuese në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në vitin 2015, është realizuar shitja formale (fiktive) me nr. {***} rep., e nr. {***} kol., datë 09.02.2015, nga shitësit E. dhe A. K. te blerësit A., kundrejt çmimit 2.868.051 lekë, me qëllim

realizimin e regjistrimit në regjistrat publikë të apartamentit në favor të blerësve, të cilët *de facto* ishin bërë pronarë të kësaj pasurie që në vitin 2011, duke e fituar pronësinë nga subjekti i rivlerësimit, i cili ishte pronari real i apartamentit, pasi e kishte poseduar dhe gëzuar për shumë vite, si dhe disponuar lirisht nëpërmjet shitjes në vitin 2011, duke i dhënë fund njëkohësisht të drejtës së pronësisë mbi apartamentin.

17.11 Kalimi i pronësisë së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit të blerësit H. dhe N. A., nëpërmjet aktmarrëveshjes së datës 25.03.2011, nuk është paraqitur pranë organeve shtetërore, të cilat luajnë rolin e agjentit të vjeljes së detyrimit tatimor, siç është në këtë rast Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, për arsyet e shpjeguara më lart. Në aktmarrëveshjen e cituar më sipër, është parashikuar si detyrim i subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, ndër të tjera edhe nënshkrimi i kontratës së shitjes pas dorëzimit përfundimtar të objektit. Ky detyrim i subjektit nuk rezulton të jetë përmbushur prej tij, për arsye se ai nuk është përfshirë si palë në kontratën e shitjes me nr. {***} rep., e {***} kol., datë 09.02.2015, në të cilën si palë shitëse rezulton E. dhe A. K., kurse si blerës H. dhe N. A.. Në rast se në këtë kontratë do të ishte pasqyruar situata e vërtetë faktike, ku shitësit realë të pasurisë së paluajtshme duhet të ishin subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, atëherë subjekti i rivlerësimit do të kishte detyrimin të paguante tatimin për të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në përputhje me legjislacionin tatimor të kohës¹⁵, ku parashikohej se tatimi për kalimin e së drejtës të pronësisë paguhet nga shitësi para kryerjes së regjistrimit të pasurisë. Një detyrim të tillë, subjekti i rivlerësimit duhej ta shlyente në vitin 2015, në momentin që është nënshkruar kontrata e shitjes e cituar më sipër, e cila nëse do të hartohej sipas parashikimeve të aktmarrëveshjes së vitit 2011, do të duhej të kishte të referuar të njëjtin çmim për shitjen e apartamentit, e si palë nënshkruese duhej të përfshihej edhe subjekti i rivlerësimit. Në këtë mënyrë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si agjent tatimor, do të vilte tatimin mbi të ardhurat e realizuara sipas çmimit real të shitjes së apartamentit, duke shëruar kështu edhe mospagimin në kohë të këtij detyrimi tatimor. Fakti që subjekti i rivlerësimit ka devijuar nga përfshirja e tij në kontratën e shitjes së formalizuar në vitin 2015, përforcon bindjen e trupit gjykues se ka dashur të shmangë pagimin e detyrimit tatimor për të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në vitin 2011 në Elbasan.

17.12 Përveç sa më sipër, në shkronjën “d” të nenit 4, me titull “Burimi i të ardhurave”, të ligjit nr. 8438/1998, janë parashikuar si burim të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë. Me ligjin nr. 20/2012, datë 01.03.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, u ndryshua neni 13 i ligjit nr. 8438/1998 si vijon:

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave (DIVA)

1. Tatimpaguesit individë, rezidentë në Republikën e Shqipërisë, që realizojnë të ardhura të tatuashme në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, dorëzojnë deklaratën vjetore të

¹⁵ Në pikën 2 të nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, parashikohej: “Tatimi paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore. Deklarues të të ardhurave individuale vjetore janë edhe tatimpaguesit jorezidentë, të cilët krijojnë të ardhura të tatueshme me burim në Republikën e Shqipërisë.

2. Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.

3. Çdo deklaratë individuale vjetore e të ardhurave plotësohet me numrin e identifikimit personal në letërnjoftimin e individit, i cili shërben si kodi fiskal i individit. Edhe në rastin kur individ është person jorezident në Republikën e Shqipërisë, si kod fiskal shërben numri i identifikimit personal në letërnjoftimin e individit.

4. Përfshihen nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2.000.000 (dy milionë) lekë. [...]

17.13 Sipas këtij parashikimi, çdo individ që krijon të ardhura të tatueshme në Republikën e Shqipërisë, duhet të dorëzojë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore deri me 30 prill të vitit që pason periudhën tatimore. Ky ligj ka hyrë në fuqi më datë 11.04.2012, për deklarimin e periudhës tatimore të vitit 2011. Në kushtet e ekzistencës së këtij detyrimi ligjor, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit duhet ta kishte deklaruar në deklaratën DIVA të ardhurën e krijuar në vitin 2011, duke krijuar një diferencë pozitive nga shitja në blerje e apartamentit në Elbasan. Vetë subjekti i rivlerësimit e trajton aktmarrëveshjen e datës 25.03.2011 si kontratë shitjeje në ankim, pasi në përfundim të këtij shkaku ankimi, i kërkon Kolegjit që e ardhura e përfituar nga shitja e apartamentit në vitin 2011, duhet të përfshihet në analizën e tij financiare (paragrafi 58.14 i ankimit).

17.14 Në përfundim të analizës së këtij shkaku ankimi, Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka realizuar shitjen e apartamentit të banimit me sip. 120 m² të ndodhur në Elbasan, nëpërmjet aktmarrëveshjes së datës 25.03.2011. Nëpërmjet kësaj aktmarrëveshjeje, subjekti i rivlerësimit ka shitur jo vetëm të drejtat reale, por edhe pasurinë e paluajtshme apartament banimi, duke gjeneruar një fitim të konsiderueshëm për të cilin nuk ka paguar detyrimet tatimore. Meqenëse akti me të cilin ka kryer kalimin e pronësisë nuk ishte kontratë shitjeje, e cila nuk mund të realizohej për shkak se pasuria nuk ishte e regjistruar, subjekti i rivlerësimit duhej ta deklaronte fitimin e realizuar në deklaratën DIVA për të paguar detyrimin tatimor që i takonte për fitimin e realizuar. Si rrjedhojë e sa më sipër, pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk kishte detyrim për të paguar tatim, pasi ka kaluar të drejta reale dhe jo të drejtën e pronësisë, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj. Sa më sipër, të ardhurat që subjekti i rivlerësimit ka realizuar nga shitja e këtij apartamenti, nuk përbëjnë të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si rrjedhojë afektojnë çdo pasuri tjetër të krijuar me këtë burim të ardhurash, duke e gjetur të drejtë konkluzionin e Komisionit për të mos i përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, si burim që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit te rezidenca “{***}”, Tiranë.

18. *Lidhur me depozitën në bono thesari, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit, se kjo depozitë e hapur në vitin 2011, e cila ka për burim të ardhurat nga*

shitja e të drejtave reale të apartamentit në Elbasan, nuk është krijuar me burime të ligjshme. Subjekti pretendon se këto të ardhura janë plotësisht të ligjshme, si rrjedhojë edhe burimi që ka shërbyer për krijimin e depozitës në bono thesari është tërësisht i ligjshëm.

18.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2011, duket se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e pagesës për prenotimin e apartamentit të “{***}”, krijimin e kursimeve cash dhe krijimin e depozitës në bono thesari. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë faktin se depozita gjendje në bono thesari, deklaruar në deklaratën “vetting”, rrjedh nga depozita në bono thesari e hapur në vitin 2011, me burim shitjen e pasurisë në Elbasan, Komisioni konstaton se subjekti/personi i lidhur nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e saj – fakt ky i evidentuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni për mundësinë e kryerjes së pagesave për blerjen e apartamentit të “{***}”, Tiranë.*

18.2 Kolegji vëren se në deklaratën *vetting*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar gjendje në bono thesari në datën 20.01.2017, vlera prej 7.000.000 lekësh dhe se zotëron 100% të kësaj pasurie. Si burim krijimi, personi i lidhur ka deklaruar: (i) diferencën ndërmjet çmimit të përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan me çmimin e blerjes së apartamentit të “{***}” në Tiranë; (ii) kursimet nga pagat ndër vite; dhe (iii) interesat bankarë të përfituar. Bazuar në shkresën me nr. {***} prot., datë 11.09.2019, të Bankës së Shqipërisë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka investuar¹⁶ në bono thesari që prej vitit 2002 e në vijim.

18.3 Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, rezulton se Alpha Bank, nëpërmjet shkresës me nr. {***} prot., datë 16.09.2019, ka paraqitur në Komision gjendjet e llogarive bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Nga këto të dhëna, rezulton se më datë 25.03.2011, është transferuar në llogarinë e znj. M. M., shuma prej 12.300.000 lekësh, me përshkrimin: “Kalim nga N. A. për blerje apartamenti”. Në datën 06.10.2011, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka aplikuar për bono thesari në shumën 4.700.000 lekë. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, i cili konfirmon edhe burimin e deklaruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2011, kjo depozitë është krijuar nga të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sip. 120 m² në Elbasan.

¹⁶ - Në vitin 2002, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 650.000 lekë.
- Në vitin 2003, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 600.000 lekë.
- Në vitin 2004, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 1.000.000 lekë.
- Në vitin 2005, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 1.000.000 lekë.
- Në vitin 2006, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 811.075 lekë.
- Në vitin 2007, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 800.000 lekë.
- Në vitin 2008, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 800.000 lekë.
- Në vitin 2009, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 0 lekë.
- Në vitin 2010, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 0 lekë.
- Në vitin 2011, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 4.700.000 lekë.
- Në vitin 2012, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 0 lekë.
- Në vitin 2013, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 0 lekë.
- Në vitin 2014, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 4.200.000 lekë.
- Në vitin 2015, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 5.500.000 lekë.
- Në vitin 2016, gjendja më 31 dhjetor ka qenë 7.000.000 lekë.

18.4 Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në Elbasan, të analizuar në paragrafin 17, më sipër në këtë vendim, sipas të cilit rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat e përfituara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së apartamentit, trupi gjykues vlerësoi të mos merren në konsideratë si të ardhura të krijuara nga burime financiare të ligjshme. Si rrjedhojë e këtij konkluzioni, nuk do të konsiderohet e krijuar me burime financiare të ligjshme edhe depozita në bono thesari, e cila është formuar pikërisht nga të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit 120 m² në Elbasan.

Në përfundim të analizës së këtij shkak ankimi, nga kontrolli që Kolegji i bëri analizës financiare të Komisionit, rezultoi se në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasurinë apartament banimi në rezidencën “{***}”, Tiranë, investimin në bono thesari në shumën 4.700.000 lekë, si dhe të përballonin shpenzime e të krijonin kursime për diferencën negative në shumën 7.520.681 lekë, duke u gjendur në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 19. Lidhur me pasurinë e luajtshme automjet, tip “Mercedes Benz”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk i ka kërkuar asnjë shpjegim apo nuk i ka njoftuar atij asnjë gjetje e cila mund ta çonte në marrjen e masës disiplinore dhe, si rrjedhojë, nuk i ka kaluar as barra e provës. Subjekti i rivlerësimit argumenton se rregullat për kalimin e barrës së provës duhet të zbatohen me ekzaktësi dhe korrektësi nga institucionet e rivlerësimit, për shkak se mosrespektimi i tyre cenon drejtpërdrejt procesin e rregullt ligjor. Nuk mund të ketë mbrojtje efektive nëse gjetjet apo akuzat nuk i njoftohen qartësisht subjektit. Komisioni në rastin konkret duhet të referojë jo vetëm gjetjen, por edhe shkeljen disiplinore përkatëse sipas parashikimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti pretendon se Komisioni ka marrë masën disiplinore mbi bazën e dyshimeve, jo mbi fakte të vërtetuara. Subjekti ka bashkëlidhur ankimit një dokument¹⁷, të cilin pretendon se nuk e ka paraqitur në Komision, duke qenë se nuk iu kalua barra e provës. Në përfundim të këtij shkak ankimi, subjekti pretendon se konkluzionet në vendim për automjetin, janë në kundërshtim me të dhënat e administruara, por edhe me parimet e procesit të rregullt.**

19.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Pasi vlerësoi me objektivitet dhe paanësi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, në harmoni me provat e administruara në dosje, Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit janë bindëse lidhur me pasaktësinë e bërë në deklarinimin gjatë pyetësorëve se e ka përdorur këtë mjet gjatë vitit 2007, por nuk janë bindëse shpjegimet e dhëna për marrëdhënien e tij me shtetasin E. M., dhe faktin se pse ai i ka lënë prokurë të posaçme me tagra të plota mbi këtë pasuri. Në vlerësimin përfundimtar lidhur me këtë pasuri, duke analizuar në harmoni me provat e administruara në dosje gjatë hetimit administrativ, duket se ky automjet, që nga momenti i hyrjes në Republikën e Shqipërisë, është përdorur dhe poseduar nga*

¹⁷ Shkresa e AMF nr. {***} prot., datë 11.12.2020, sipas së cilës për automjetin tip “Benz Mercedes”, me targë {***} ({***}), nuk rezultojnë asnjë policë sigurimi për periudhën 24.04.2009 - 14.01.2015. Polica MTPL për periudhën 25.04.2009 - 14.01.2015 nuk rezultojnë të ketë policëmbajtës subjektin e rivlerësimit.

subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, duket se në vazhdimësi subjekti i rivlerësimit është sjellë si pronar i këtij automjeti, çka bën që Komisioni të ngrejë dyshimin e arsyeshëm se kjo pasuri që në prill të vitit 2008 është porositur dhe blerë nga subjekti i rivlerësimit, por për rreth 7 vjet është munduar të fshehtë ekzistencën dhe deklarimin e burimit të pagesës së kryer për blerjen e tij.

19.2 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Autoveturë, marka “Mercedez-Benz”, tip “C220 CDI”, vit prodhimi 2003, me targë {***}, blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 13.01.2015, burimi i krijimit është nga të ardhurat nga pagat ndër vite. Vlera 3.000 euro.*

Në DIPP-në e vitit 2015 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë blerjeje automjeti, tip “Benz-Mercedes 220, E Class”, viti 2003, nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 13.01.2015 (nga kursimet), vlera 3.000 (tremijë) euro + 1.000 (një mijë) euro dogana + taksat.*

19.3 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se shitësi E. M., i përfaqësuar me prokurë nga subjekti i rivlerësimit, i ka shitur vetë subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet kontratës së shitjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 13.01.2015, automjetin e markës “Daimler Chrysler AG”, me çmimin 3.000 euro, shumë e cila, sipas kontratës së shitjes, është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Në datën 30.04.2008, individit E. M., nëpërmjet prokurës së posaçme¹⁸, ka autorizuar subjektin e rivlerësimit të kryente procedurat e zhdoganimit dhe regjistrimit të këtij mjeti, ta përdorte atë brenda dhe jashtë vendit, si dhe të kryente të gjitha procedurat për shitjen, duke vendosur vetë për çmimin dhe mënyrën e likuidimit/ose të kryente të gjitha procedurat për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të tij. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në datën 12.01.2015, subjekti i rivlerësimit ka kryer zhdoganimin e këtij mjeti, duke paguar në total detyrimet doganore dhe taksat për zhdoganimin e tij në vlerën prej 53.641 lekësh dhe më datë 13.01.2015, është nënshkruar kontrata e shitblerjes së këtij mjeti, e cituar më sipër në këtë paragraf. Sipas kësaj kontrate, ku në cilësinë e shitësit ka nënshkruar subjekti i rivlerësimit, si përfaqësues me prokurë i z. E. M., çmimi i shitjes së automjetit është përcaktuar 3000 euro, i cili është likuiduar jashtë zyrës noteriale, para hartimit të kontratës së shitjes së automjetit.

19.4 Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, ka pyetur subjektin e rivlerësimit nëse e ka pasur në përdorim këtë automjet dhe për marrëdhënien që ai ka pasur me z. E. M., në përgjigje të të cilit subjekti i rivlerësimit shpjegoi se këtë automjet e ka përdorur vetëm 2-3 muaj në vitin 2007, më pas nuk e ka përdorur më dhe se z. E. M. ka qenë mik i një shokut të tij. Komisioni ka konstatuar se nga të dhënat e sistemit “TIMS” rezulton se në datën 28.11.2011, subjekti i rivlerësimit me këtë mjet ka kryer dalje/hyrje nga pika kufitare e Qafë Thanës. Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime për mospërputhjet në deklaratimet e tij, të sqarojë marrëdhënien me E. M., si dhe faktin se pse i ka lënë prokurë të posaçme me tagra të plota për këtë pasuri.

19.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka sqaruar se: *Me shtetasin E. M., jam njohur në qytetin e Durrësit, përpara vitit 2008, nëpërmjet shokut dhe kolegut tim të punës*

¹⁸ *Prokura e posaçme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.04.2008.*

*K. B.. Në muajin prill të vitit 2008, unë dhe Kreshniku jemi takuar me E. për të pirë kafe. Në bisedë e sipër, meqenëse unë nuk kisha makinë në përdorim në atë kohë, E. më sugjeroi makinën e tij, të tipit “Benz”, me targë {***}, për ta përdorur, me të cilën kishte ardhur atë muaj nga Italia, derisa unë të blija një makinë. Për këtë fakt, ai përpiloi një prokurë në të cilën përveç së drejtës për ta përdorur, më ka dhënë edhe të drejtën që këtë automjet ta shisja te çdo person, pasi ai do largohej përsëri për në Itali. Këtë automjet e kam përdorur disa muaj në vitin 2008 (viti 2007 në deklarinimet e mëparshme është lapsus nga ana ime) deri kur unë kam blerë automjetin “Opel Corsa” (18 shtator 2008, deklaruar dhe në DPV-në e vitit 2008). Më pas, automjetin e mësipërm, meqenëse E. ndodhej në Itali, e kam dorëzuar së bashku me Kreshnikun pranë familjarëve të tij që banojnë në Durrës. Në nëntor të vitit 2011, jemi takuar përsëri në Durrës, ku E. sapo kishte ardhur nga Italia dhe gjatë bisedës me të, ai më sugjeroi të blija automjetin e sipërcituar. Pasi ramë dakord, unë e kam marrë automjetin për ta provuar nga ana teknike, duke bërë një rrugë deri në Ohër të Maqedonisë. Në momentin e kalimit në pikën kufitare Qafë Thanë, automjeti ka pësuar probleme teknike, të cilat më kanë detyruar të kthehem. Kjo vërtetohet dhe nga sistemi TIMS, ku hyrja dhe dalja është në një interval kohe afërsisht prej 5 minutash. Në këto kushte, ia kam kthyer automjetin përsëri në fillim të muajit dhjetor 2011, kur dhe ai ka ardhur në Shqipëri. Në vitin 2015, gjatë një bisede në rrjetet sociale, ka rënë fjala për automjetin e mësipërm dhe më ka thënë përsëri, që nëse isha akoma i interesuar, ta blija në vlerën prej 3.000 eurosh pa doganë. Pasi automjeti që në gjendje të mirë teknike dhe unë isha i pajisur me prokurë, kam kryer procedurat e zhdoganimit të automjetit duke paguar dhe taksat për ditët e qëndrimit në Shqipëri, dhe më pas duke kryer targimin e mjetit në emrin tim. Shumën prej 3.000 eurosh ua kam dhënë familjarëve të tij.*

19.6 Kolegji vëren se nga rrethanat faktike të konstatuara më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit pohoi se e ka përdorur këtë automjet për një kohë të shkurtër, në një kohë që për shtatë vite me radhë, nga momenti që është përfaqësues me prokurë në vitin 2008 deri në momentin e blerjes së automjetit në vitin 2015, ka pasur të drejtën ta përdorë, t’ua japë të tretëve në përdorim, si dhe ta shesë me çmimin që do vendoste vetë. Liria për të vendosur në mënyrë subjektive (sipas tagrave të prokurës) për pasurinë që i përket një personi tjetër, ka bërë që Komisioni t’i kërkojë informacion¹⁹ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës (subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën deri në vitin 2011 pranë kësaj prokurorie) për të konfirmuar nëse për shtetasin E. M. ka pasur procedim penal të mosfilluar, të pushuar, të pezulluar apo të dërguar për gjykim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke i kërkuar t’i dërgojë kopje të fashikujve përkatës. Kjo prokurori i ka kthyer përgjigje²⁰ Komisionit se, pas verifikimeve të kryera në zyrën e regjistrimit, rezultoi se nuk ka të regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur. Gjithashtu, nga informacioni²¹ i dërguar në Komision nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nuk rezultoi të ketë policë sigurimi në emër të subjektit të rivlerësimit për këtë mjet, gjatë periudhës që ishte në fuqi prokura, prej së cilës subjekti ishte përfaqësues i z. E. M. për shitjen e automjetit.

¹⁹ Shkresa nr. {***} prot., datë 10.06.2020.

²⁰ Shkresa nr. {***} prot., datë 16.06.2020.

²¹ Shkresa e AMF-së me nr. prot. {***}, datë 26.09.2019.

19.7 Nga kontrolli që i bëri Kolegji analizës financiare të Komisionit për vitin 2015, vit në të cilin është nënshkruar edhe kontrata e shitjes së automjetit me targë {***}, subjekti i rivlerësimit rezultoi me të ardhura të mjaftueshme për krijimin e pasurisë automjet, kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve të këtij viti.

19.8 Për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni nuk i ka kërkuar asnjë shpjegim apo nuk i ka njoftuar asnjë gjetje, e cila mund ta çonte në marrjen e masës disiplinore dhe, si rrjedhojë, nuk i ka kaluar as barra e provës. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji vëren se Komisioni në rezultatet e hetimit për këtë pasuri i ka kaluar barrën e provës duke i kërkuar shpjegime si vijon: *Për sa sipër, kërkojmë të jepni shpjegime për mospërputhjet në deklaratimet tuaja, si edhe të sqaroni në mënyrë shteruese marrëdhënien e plotë me shtetasin E. M. dhe faktin se pse ai ju ka lënë prokurë të posaçme me tagra të plota mbi këtë pasuri.* Kolegji vëren se Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me marrëdhënien me z. E. M., i cili i ka lënë një prokurë me tagra të plota. Në këtë kontekst, nga Komisioni, nëpërmjet kërimit të shpjegimeve, i ka dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit për ta kundërshtuar rezultatin e hetimit administrativ, duke dërguar prova, parashtrime apo shpjegime. Rezulton se subjekti nuk paraqiti asnjë dokument në Komision për të sqaruar pyetjen e Komisionit, si rrjedhojë nuk është i bazuar pretendimi se nuk pati mundësinë të mbrohet për rezultatet e hetimit. Shkresa e AMF-së, të cilën subjekti ia ka bashkëngjitur ankimit dhe kërkoi të merrej si provë nga Kolegji për shkak se nuk ka pasur mundësi ta dorëzojë në Komision, ngaqë nuk i ka kaluar barrën e provës, përbën informacion i cili gjendet i administruar në dosjen e Komisionit, cituar edhe në paragrafin 19.6 më sipër.

19.9 Në përfundim të analizimit të këtij shkak ankimi, Kolegji vlerëson se, pavarësisht ekzistencës së disa fakteve të konstatuara, siç është dhënia e prokurës së posaçme dhe tagrat e lënë nëpërmjet saj nga viti 2008 deri në vitin 2015, kalimi i pronësisë së mjetit te subjekti i rivlerësimit nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe mospërputhjet në lidhje me sqarimet që subjekti ka dhënë për përdorimin e këtij mjeti, mund të sqaroheshin nga Komisioni nëpërmjet një hetimi të thelluar, të legjitimuar nga ekzistenca e dyshimeve për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit. Kjo mënyrë trajtimi nga e Komisionit sjell si pasojë mosngritjen e kësaj problematike në një shkak autonom për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Nga ana tjetër, rrethanat faktike të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me blerjen e automjetit, si dhe përdorimin e tij, mbeten jobindëse për trupin gjykues, ndaj tërësia e këtyre fakteve dhe rrethanave, si dhe pesha e tyre në procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Alket Mersini, u morën në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, lidhur me besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit në vlerësimin e pasurisë.

20. ***Lidhur me transfertën nga shoqëria “{***}” ShPK*** në llogarinë e bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit pretendon se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se llogaria e hapur në Union Bank nga bashkëshortja e subjektit, në ditën e kryerjes së transfertës nga shoqëria “{***}” ShPK ngre hije dyshimi se qëllimi i kryerjes së këtij transaksioni lidhet me një trajtim të mundshëm preferencial nga shoqëria lidhur me çmimin e apartamentit. Edhe për këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk i ka kaluar barra e provës nga Komisioni, duke mos i garantuar të drejtën e mbrojtjes, në shkelje të procesit të rregullt ligjor. Subjekti pretendon se nuk ka asnjë

provë shkresore ose të dhënë që të provojë se gjatë detyrës, subjekti të ketë hetuar ndonjë çështje penale që ka të bëjë me shoqërinë “{***}” ShPK, si dhe çmimi i blerjes së apartamentit nuk ka qenë favorizues, bazuar në çmimin e vendosur në kontratën e shitjes, referencat e publikuara nga Enti Kombëtar i Banesave dhe çmimi në kontrata të tjera të ngjashme. Subjekti i rivlerësimit argumenton se ka sqaruar situatën e kalimit të shumës 40.774 euro nga shoqëria “{***}” ShPK në llogarinë e bashkëshortes së tij M. M. në datën 31.10.2011, si një veprim i cili është kryer gabimisht nga ana e shoqërisë dhe, si i tillë, është rregulluar brenda ditës. Subjekti shpjegon se vlera është tërhequr nga llogaria bankare e bashkëshortes dhe pas sqarimit është depozituar në arkën e shoqërisë, e cila ndodhej pranë banesës së tyre dhe po atë ditë shoqëria “{***}” ShPK e ka ridepozituar në llogarinë e saj bankare.

20.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje: *Në vlerësimin përfundimtar, në dritën e fakteve të reja nga ku duket se llogaria në “Union Bank” është hapur nga bashkëshortja në ditën e kryerjes së transfertës nga shoqëria “{***}” ShPK, trupi gjykues çmon se nuk duken bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe se ka hije dyshimi për qëllimin e kryerjes së këtij transaksioni, të lidhura me trajtim të mundshëm preferencial nga shoqëria për çmimin e blerjes së apartamentit të “{***}”.*

20.2 Kolegji vëren se në dokumentacionin e administruar në dosje, gjendet shkresa e Union Bank²², e cila konfirmon se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka hapur llogari bankare në euro, në datën 31.10.2011, pranë ish-Bankës Ndërkombëtare Tregtare, e cila sot është Union Bank. Në po të njëjtën datë, rezulton se është transferuar nga shoqëria “{***}” ShPK, shuma 40.774 euro, me përshkrimin: “Për sa paguar tepër kështu apartamenti”. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit po në të njëjtën ditë, e ka tërhequr *cash* të gjithë këtë shumë nga llogaria e saj. Likuidimi i pagesës për blerjen e apartamentit të “{***}” është kryer në mënyrë periodike, me pagesa të ekzekutuara *cash* pranë shoqërisë, si vijojnë: (i) më datë 05.04.2011, është paguar shuma prej 3.200.000 lekësh; (ii) më datë 04.05.2011, është paguar shuma prej 3.100.000 lekësh; dhe (iii) më datë 18.05.2010, është paguar shuma prej 15.000 eurosh.

20.3 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, lidhur me këtë transfertë, për të cilën, në përgjigje, subjekti i rivlerësimit sqaroi se: *Shuma prej 40.774 eurosh, e tërhequr nga llogaria e shoqërisë “{***}” ShPK, nga bashkëshortja, znj. M. M., në datë 31.10.2011, është një veprim i kërkuar gabimisht nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK, e cila e konstatoi dhe e korrigjoi këtë gabim po brenda ditës. Konkretisht, shuma e mësipërme e tërhequr nga bashkëshortja, u depozitua në arkën e shoqërisë, e cila, po atë ditë e ka depozituar të njëjtën shumë në llogarinë bankare të saj. Kjo provohet nga mandati i arkëtimit në arkën e shoqërisë nga M. M., nga deklarata e shoqërisë për këtë gabim, si dhe llogaria bankare e shoqërisë, në të cilën është riderdhur shuma e tërhequr gabimisht po atë ditë. Subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dokumentacionin si vijon: (i) deklaratë e shoqërisë “{***}” ShPK nr. {***} prot., datë*

²² Shkresa me nr. {***} prot., datë 26.09.2019.

16.10.2018; (ii) gjendje e llogarisë bankare të shoqërisë “{***}” ShPK; (iii) mandatarkëtimi, datë 31.10.2011; dhe (iv) mandatpagesë, datë 31.10.2011.

20.4 Në deklaratën e lëshuar nga administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, z. A. Ç., sqarohet se nga shoqëria, është depozituar gabimisht shuma prej 40.744 eurosh në llogarinë e znj. M. M., e cila këtë shumë e ka tërhequr dhe e ka depozituar në arkën e shoqërisë “{***}” ShPK, dhe më pas në po të njëjtën ditë (31.10.2011), shoqëria e ka ridepozituar në llogarinë e saj nëpërmjet punonjësit të saj, z. B. R..

Nga verifikimi i gjendjes së llogarisë bankare në Union Bank të shoqërisë “{***}” ShPK, rezulton se në datën 31.10.2011, është transferuar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit shuma prej 40.774 eurosh, me përshkrimin: “Për sa paguar më tepër këste kontrate apartamenti”. Po në këtë datë, nga punonjësi i shoqërisë ndërtuese, është depozituar shuma 40.774 euro në llogarinë e kësaj shoqërie, me përshkrimin: “Derdhur nga B. R.”.

Sipas mandatarkëtitimit me nr. {***}, rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, brenda ditës ka depozituar pranë arkës së shoqërisë “{***}” ShPK, shumën prej 40.774 eurosh, të pretenduar nga subjekti si të hedhur gabimisht në llogari. Ky mandatarkëtimi është plotësuar me shkrim dore, me përshkrimin e këtij veprimi: “Sa arkëtuar për arsye fiskale”.

20.5 Komisioni konstatoi se të gjitha këto veprime janë kryer brenda datës 31.10.2011, ndaj për shkak të dyshimeve të arsyeshme, i kërkoi subjektit të japë shpjegime shtesë dhe të paraqesë prova të reja për të sqaruar çështjet si vijojnë:

(i) Si e dispononte shoqëria ndërtuese numrin e llogarisë së bashkëshortes së subjektit, kur të gjitha pagesat për blerjen e pasurisë janë kryer *cash* te kjo shoqëri?

(ii) Kush e njoftoi bashkëshorten e tij për transferimin e kësaj shume në llogarinë e saj?

(iii) Si u bë e mundur tërheqja e kësaj shume në bankë brenda ditës, duke konsideruar faktin se për tërheqjet e vlerave monetare në shuma të konsiderueshme, referuar rregulloreve të bankave, duhet bërë njoftimi disa ditë përpara?

(iv) Pse bashkëshortja e tij nuk e ktheu këtë shumë nëpërmjet transfertës bankare?

20.6 Në përgjigje të gjetjeve të Komisionit, me prapësimet e rezultateve të hetimit, lidhur me sa konstatuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Çështjet e ngritura nga ana juaj, kanë të bëjnë me natyrën operacionale të kryerjes së këtij transaksioni, i cili ka ndodhur shumë vite më parë, për të cilin ne nuk na kujtohen detajet e kryerjes së këtij transaksioni. Theksoj se unë dhe familja ime nuk kemi përfituar ndonjë vlerë monetare nga kryerja e këtij transaksioni, përveç faktit të sistemimit të gabimit të kryer nga shoqëria “{***}” ShPK, i cili përbën dhe thelbin e këtij transaksioni, dhe që është provuar edhe me prova të administruara gjatë hetimit paraprak, si: (i) deklaratë e shoqërisë “{***}” ShPK nr. {***} prot., datë 16.10.2018; (ii) gjendje bankare e llogarisë së shoqërisë “{***}” ShPK; (iii) mandatarkëtimi, datë 31.10.2011; dhe (iv) mandatpagesë, datë 31.10.2011. Për sa më sipër, unë nuk kam prova të reja të mundshme, përveç atyre të paraqitura gjatë hetimit administrativ. Si konkluzion, të dhënat e pasqyruara në provat bashkëlidhur këtyre parashtrimeve, analiza dhe shpjegimet e dhëna provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm të kundërtën e barrës së provës që më është ngarkuar.*

20.7 Komisioni i ka kërkuar informacion²³ Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për të konfirmuar nëse shoqëria “{***}” ShPK, si dhe shtetasi G. S.²⁴ ka pasur procedim penal të mosfilluar, të pushuar, të pezulluar apo të dërguar për gjykim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku në rast se ka rezultate, të dërgojë kopje të fashikujve përkatës. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka kthyer përgjigje²⁵ se, pas verifikimeve të kryera në zyrën e regjistrimit, rezulton se kjo prokurori nuk ka të regjistruar procedim penal në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur, si dhe as për subjektin juridik.

20.8 Kolegji vëren se Komisioni e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për problematikat e rezultuara gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, të cilat janë renditur në paragrafin 20.5 më sipër, duke i dhënë mundësi subjektit të rivlerësimit të paraqesë prova e shpjegime për të provuar të kundërtën e asaj çfarë është konstatuar, pasi jo në çdo rast mund të jetë i identifikueshëm nga Komisioni kualifikimi i shkeljes së kryer nga subjekti i rivlerësimit, para përgjigjeve të barrës së provës, për arsye se kjo do ta bënte procesin paragjykses. Në përfundim, edhe për këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit lidhur me kalimin e barrës së provës, trupi gjykues vlerësoi se nuk është cenuar parimi i procesit të rregullt ligjor, si rrjedhojë nuk evidentohen shkelje të rënda procedurale nga ato të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në ankim.

20.9 Nga situata faktike e rezultuar si rrjedhojë e shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion, të administruar në dosjen e Komisionit, dyshimet e Komisionit janë të drejta lidhur me transaksionin e kryer nga shoqëria ndërtuese në të njëjtën ditë që bashkëshortja e subjektit kishte hapur llogarinë, si dhe përgjigjen e shpejtë të kësaj të fundit për t’i tërhequr dhe depozituar në arkën e shoqërisë, e më pas shoqëria depozitim në bankë. Duken si veprime të organizuara për një qëllim të caktuar, por shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, si dhe nuk janë sqaruara për veprimet e kryera nga të dyja palët. Nga mënyra si janë kryer këto transaksione, krijojnë bindjen që nuk janë kryer gabimisht dhe pikërisht këtë bindje e përforcon fakti që shuma është hedhur në llogarinë bankare të bashkëshortes në të njëjtën ditë kur kjo e fundit ka hapur llogarinë bankare në Union Bank. Pagesat për blerjen e apartamentit, të cituara në paragrafin 20.2 më sipër, janë ekzekutuar *cash* te shoqëria e ndërtimit, ndaj nuk është provuar që këto pagesa janë reale, duke mos qartësuar nëse shlyerja e apartamentit është paguar më tepër, apo çmimi i tij ka qenë aq sa është treguar në kontratën për ndërtim apartamenti (58.400 euro). Nga ana tjetër, edhe Komisioni i cili ka konkluduar për trajtim të mundshëm preferencial, nuk ka dhënë indicie apo detaje mbi bazën e cilave prova ka arritur në këtë konkluzion, pasi nuk është provuar që subjekti i rivlerësimit ka kryer favore ndaj shoqërisë ndërtuese, të cilat rrjedhin për shkak të detyrës së tij. Në përfundim të analizës së këtij shkak ankimi, rrethanat faktike të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me transfertën e shumës nga shoqëria “{***}” ShPK, mbeten jobindëse për trupin gjykues, ndaj

²³ Shkresa nr. {***} prot., datë 10.06.2020.

²⁴ Përfaqësues i shoqërisë “{***}” ShPK në lidhjen e kontratës së kaparit për blerjen e apartamentit të “{***}”, Tiranë.

²⁵ Shkresa nr. {***} prot., datë 16.06.2020.

tërësia e këtyre rrethanave dhe pesha e tyre në procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, u morën në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes lidhur me besueshmërinë e subjektit të rivlerësimit në vlerësimin e pasurisë.

21. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nga Komisioni, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues i Kolegjit arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Alket Mersini gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 296, datë 16.09.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 296, datë 16.09.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Alket Mersini.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 24.07.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi